



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2023

VENDIM

Nr. 110, datë 13.03.2023

PËR

**TRANSFERIMIN E GJYQTARIT Z. {...}, NË GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË NË NJË POZICION TË LIRË NË FUSHËN E SË DREJTËS PENALE**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 4, të nenit 135, pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 44, pika 1, shkronja “b” dhe nenin 162, pikat 1, 3 dhe 4, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin nr. 130, datë 30.03.2020 “Për deklarimin e mbarimit të caktimit të përkohshëm dhe transferimin e gjyqtarit z. {...}” të Këshillit të Lartë Gjyqësor, referuar Vendimit nr. 51 datë 27.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi shqyrtoi zgjedhjen për tu transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme në gjykatat e shkallës së parë me juridiksionin të përgjithshëm, të gjyqtarit z. {...} protokolluar me aktin nr. 1103 prot., datë 08.2.2023, mbi propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Transferimin e gjyqtarit z. {...}, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR